



Pranimar / Dorezuar Punimjen / Prodato Received / Delivery	31.01.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKURTAR	1164/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.769/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.523/2022, të datës 15.12.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.769/2022 të datës 25.08.2021, të parashtruar nga ankuesi

me adresë banimi fshati Bellacer, rr. "Komunën e Rahovecit", kundër organit të punësimit/ Ministria e Drejtësisë, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.769/2021 të datës 25.08.2021 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka themeluar marrëdhënie pune në Ministrinë e Drejtësisë sipas Akt emërimit të datës 05.03.2013 në pozitën "Asistent i transportit dhe logjistikës" në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, i pakënaqur me Vendimin numër KD.Nr.03/2021 të datës 28.07.2021 nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, ankuesi me datën 25.08.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4391/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marr parasysh faktin se objekt i kësaj çështje ankimore është shqiptimi i masës disiplinore ndaj ankuesit i cili ka statusin e *Nëpunësit administrativo-teknik- dhe mbështetës*, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse:*

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafi 3 përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 6. Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike”, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pozita të cilën e mban ankuesi si Asistent i transportit dhe logjistikës hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik dhe mbështetës, gjegjësisht nuk është pozitë e shërbimit civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.769/2021 të datës 25.08.2021 të parashtruar nga ankuesi.*

Andaj, duke marr parasysh faktin se Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Drejtësisë ka nxjerrë Vendimin me numër KD-Nr.03/2021, sipas të cilit ankuesit është shqiptuar masa disiplinore e ndalimit të pagës bazë prej 20% për periudhën tre (3) mujore nga dita kur vendimi merr formën e prerë, Kolegji i Këshillit duke pasur parasysh rrethanat e konstatuara si më lartë konstaton se ankuesi me qenë se nuk e ka statusin e nëpunësit civil, si rrjedhojë as të kandidatit për praninë në Shërbimin Civil dhe për pasojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.769/2021 të datës 25.08.2021 të parashtruar nga ankuesi, ngase bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, Këshilli shqyrton dhe merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil.

Sipas nenit 79 paragrafit 2 dhe nenit 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës. Kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafit 4 dhe nenit 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Nga ajo që u tha më lartë e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.769/2022, datë 31/01/2023.

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të personelit në Ministrinë e Drejtësisë
- Udhëheqësit të Personelit në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

